



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ljiljana Subaric, Kryetare e Komunës së Graçanicës Milan Dimitrijevic, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Graçanicës
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbil Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL Datë: 21.05.2025 Nr. 020-257
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të Komunës së Graçanicës

E nderuar Kryetare,
E nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 26/2025KG për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" Sh.A.
I miratuar më datë: 29.04.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.04.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

Arsyetim

Vendimi Nr. 26/2025KG për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" Sh.A.

MAPL konstaton se akti i miratuar nga kuvendi i komunës së Graçanicës, është bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d) dhe nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 6 paragrafi 1 pika 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 pika 1 të Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës që përcakton se: *Komuna ka të drejtë të jep pronën në shfrytëzim, për institucionet sajë vartëse apo të bëjë destinimin e pronës për nevojat e sajë, pa i zhvilluar procedurat e përcaktuara më ligjin përkatës për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale, neni 2 Institucionet vartëse për të cilat komuna nuk zhvillon procedurën e përcaktuar për dhënien e pronës komunale, janë: neni 2.1 Ndërmarrjet publike lokale, sipas Ligjit përkatës për ndërmarrjet publike.*

Vendimi është miratuar në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës së Graçanicës e mbajtur me datë 29.04.2025, i miratuar me 13 vota për, 0 kundër dhe 1 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Ljiljana Subarić, gradonačelnica opštine Gračanica Milan Dimitrijević, predsedavajući Skupštine opštine Gračanica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, <i>ZA: 19.05.2025</i> Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a, <i>Scun</i>	
Od:	Erbilin Hetemi, rukovodioc Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Datum, 21.05.2025 br. 020-257
Odgovorni službenici: 1. Službenik za potvrđivanje pravne procene: 2. Službenik za izradu pravne ocene	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština <i>AK</i>	
	Maltin Shala, viši službenik za monitorisanje opština <i>MS</i>	
Predmet:	Potvrda zakonitosti	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Gračanica	

Poštovani/a gradonačelnice,
Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 26/2025KG o davanju na korišćenje nepokretne imovine opštine javno-komunalnom preduzeću „ Ekologija “ AD.
Usvojena dana, 29.04.2025.god
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 30.04.2025.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi. Dok,što se tiče sadržaja akta i obaveza prema drugim licima, su u nadležnosti opštine.

Obrazloženje

Odluka br. 26/2025KG o davanju na korišćenje nepokretne imovine opštine javno-komunalnom preduzeću „Ekologija“ AD.

MALS konstatuje da je odobreni akt od strane Skupštine opštine Gračanica, zasnovan na članu 12 stav 2 tačka d) i članu 14 stav 1 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 6 stav 1 tačka 2 i članu 14 stav 1 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 26 stav 1 i 2 tačka 1 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupaka za davanje na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, kojim je propisano da:

Opština ima pravo da daje imovinu na korišćenje svojim podređenim institucijama ili da koriste imovinu za sopstvene potrebe, bez razvoja procedura navedenih u relevantnom zakonu za davanje na korišćenje i razmenu opštinske imovine, član 2. Podređene institucije za koje opština ne razvija proceduru navedenu za davanje na korišćenje opštinske imovine su: Član 2.1 Lokalna javna preduzeća, u skladu sa relevantnim Zakonom o javnim preduzećima.

Odluka je usvojena na redovnoj sednici Skupštine opštine održanoj dana, 29.04.2025.godine sa 13 glasova za, 0 protiv i 1 uzdržan.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.